



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Auditimi i Avancuar
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I (sem. I)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrim i lëndës	
	Auditimi i Avancuar, bazohet në auditimin e pasqyrave kryesore financiare si: Bilancit të gjendjes, Pasqyra e të ardhurave, Pasqyra e rrjedhës së parasë dhe Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet . Auditimi i këtyre pasqyrave i mundëson auditorit që të shpreh opinionin e tij lidhur me këto pasqyra. Në këtë lëndë trajtohen edhe ndikimet që kanë: auditimi i pasqyrave financiare, auditimi operacional dhe i përputhshmërisë në vlerësimin e gjendjes reale të një kompanie.
Qëllimet e lëndës:	
	Qëllimi i lëndës Auditimi i Avancuar është të pajisë studentët me njohuri dhe aftësi të avancuara në auditim, duke thelluar kuptimin e tyre për standardet dhe procedurat komplekse të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Kjo lëndë synon të zhvillojë aftësitë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet financiare dhe operacionale në organizata, si dhe për të kryer auditime që përmbushin standardet ndërkombëtare. Për më tepër, studentët do të mësojnë të përdorin teknikat më të fundit të auditimit dhe të interpretojnë rezultatet për të përmirësuar performancën dhe përputhshmërinë e organizatave me rregullat dhe politikat e industrisë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	
	Njohuri (NJ): *NJ1. Zhvillon njohuri të avancuara mbi standardet dhe procedurat e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në përputhje me normat ndërkombëtare. *NJ2. Kupton dhe interpreton rreziqet financiare dhe operacionale që ndodhin gjatë proceseve të

	auditimit dhe vlerëson ndikimin e tyre në organizata dhe në vendimmarrje. *NJ3. Aftësohet në përdorimin e metodave dhe teknikave të avancuara të auditimit për të analizuar dhe vlerësuar proceset dhe procedurat e brendshme të organizatave. Aplikim-Kompetenca (A-K): **A-K1. Përdor metodat e auditimit të avancuara për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet financiare dhe operacionale të organizatave. **A-K2. Aplikon njohuritë e avancuara të auditimit për të vlerësuar dhe përmirësuar performancën e organizatave dhe përputhshmërinë e tyre me standardet dhe rregullat e industrisë. **A-K3. Aftësohet të drejtojë auditime të brendshme dhe të jashtme, duke përdorur teknika të avancuara dhe duke u fokusuar në përmirësimin e procedurave dhe politikave të brendshme të organizatave. **A-K4. Aftësohet të realizojë dhe interpretojë raportet e auditimit, duke përdorur një qasje kritike dhe analitike për të vlerësuar dhe zgjidhur problemet e mundshme në organizata. **A-K5. Kryen analizat e thella të të dhënave dhe rezultateve të auditimit për të krijuar rekomandime që kontribuojnë në përmirësimin e menaxhimit të rreziqeve dhe në rritjen e efikasitetit operativ të organizatave. Aftësi (A): ***A1. Demonstron aftësi për të prezantuar rezultatet e auditimit dhe gjetjet në mënyrë të qartë dhe bindëse për menaxhimin dhe palët e interesuara, duke përdorur prova dhe argumente të forta. ***A2. Bashkëpunon efektivisht me ekipet e auditimit dhe departamentet përkatëse brenda organizatave për të siguruar përputhshmërinë dhe rritjen e performancës financiare dhe operacionale. Sqarim: Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së.
--	--

	*Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) ***Aftësi (A)		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	5	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	1	5	5
Seminare/kollekfiume	1	15	15
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	5	15
Përgatitja përfundimtare për provim	4	2	8
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet ,etj	1	5	5
Totali			150
Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi.			
Përshtatja e ECTS me orët totale: 150 orë ÷ 25 = 6 ECTS kredi.			
Metodologjia e mësimdhënies:	Zhvillimi i leksioneve (ligjëratave) Literatura adekuate, përdorimi i mjeteve të TI dhe mjeteve tjera të konkretizimit. - Leksionet do të zhvillohen me një ngarkesë prej 3 orësh në javë për një grup leksionesh me një zgjatje prej 45 minutash secili. - Ato do të zhvillohen duke përdorur metodën e mësimdhënies interaktivë, projektin e tyre në videoprojektor për të mundësuar një efektivitet më të lartë të përvetësimit të njohurive nga ana e studentëve.		

	• Studentët janë të lirë që të pyesin dhe të kërkojnë sqarime sa herë e gjykojnë të nevojshme dhe po ashtu Profesori synon që t'i përfshijë ata në trajtimin e problemeve të vecanta. • Leksionet do të zhvillohen si në drejtimin teorik ashtu edhe praktik me ilustrime me raste studimore , ushtrime të nivelit konkretizues, etj.
Metodat e vlerësimit: Pjesëmarrja aktive gjatë mësimit Punimi seminarik Provimi (mbi 60% të përgjigjeve të sakta)	Nota përfundimtare bazohet në: Vlerësimi i notës përfundimtare përfshijnë të katër kriteret e vlerësimit: • Vijueshmeria e rregullt – 10%; • Seminari – 10%; • Projekti - 30%; • Provimi final – 50% • Gjithsej 100% Gjatë vlerësimit do të merren parasysh, përveç tjerash, edhe këto aspekte: ○ interpretimi i temës, ○ thellësia e të kuptuarit të temës, ○ shfrytëzimi i literaturës, ○ evaluimi dhe sinteza e evidencës, ○ analizat kritike dhe ○ logjika e ndërtimit të argumentit. Përveç kësaj, vëmendje në vlerësim do tu kushtohet edhe: - drejtshkrimit, - prezantimit vizual të të dhënave dhe referencave, dhe - prezantimit të përgjithshëm. Provimi ka 100 pikë. - 50-60 = 6; - 61-70 = 7; - 71-80 = 8; - 81-90= 9; - 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	Literatura bazë: 1.Bedri Statovci, Shefket JAKUPI, Auditimi i Avancuar ,Pejë , 2017 2.Materiale praktike të përgatitura nga profesori

Literatura shtesë:	Literatura shtesë: 1. Auditing and Assurance Services: A Systematic Approach, William F Messier, 2014.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezantimi i syllabuesit Hyrje në Auditim dhe shërbimet tjera të sigurisë • Hyrje në Auditim / f.3-13 / • Shërbimet tjera të sigurisë /f.54,pyetja.28,34,35;F.57, pyetja 38,39; f.61p.51 / • Pyetje për diskutim / f.16 / • Raste studimore – punë e pavarur • Mëni një rast - Auditimin eksternal dhe internal / f.13-14/ Literatura: Libri - Auditimi i avancuar
Java e dytë:	Standardet profesionale të auditimit dhe etika e auditorëve • Standardet profesionale të auditimit / f.27-30,32-33/ • Etika e auditorëve /f.43-45/ • Pyetje për diskutim / f.48-62 / • Raste studimore – punë e pavarur • Mëni një rast – SNA / f.28,29,30 / Literatura: Libri - Auditimi i avancuar
Java e tretë:	Përgjegjësi ligjore e auditorëve • Përgjegjësi ligjore e auditorëve / f.105,112,119/ • Konflikt interesave për audituesit / f.120/ • Pyetje për diskutim / f.57,pyetja 37/ • Raste studimore – punë e pavarur • Mëni një rast – për shkeljet civile dhe penale Literatura: Libri - Auditimi i avancuar
Java e katërt:	Planifikimi i auditimit, njohja e klientit, vlerësimi dhe reagimi ndaj rreziqeve • Planifikimi i procesit të auditimit/ f.122 / • Pyetje për diskutim / f.137 analizoni diagramin e planifikimit të auditimit, Form.1001 f.123/ • Raste studimore – punë e pavarur • Mëni një rast –planifikim të auditimit Literatura: Libri - Auditimi i avancuar
Java pestë:	Auditimi në sektorin publik • Auditimi në sektorin publik / f.111-121/ • Pyetje për diskutim • Raste studimore – punë e pavarur • Trajtoni formularët e auditimit të brendshëm f.123-136 duke marrë raste nga praktika e auditorëve Literatura: Libri - Auditimi i avancuar
Java gjashtë	Dosjet e auditimit Evidencat, llojet e evidencave dhe dokumentet e punës /f.181-183? • Pyetje për diskutim / f.184-tab.28-29/ • Raste studimore – punë e pavarur • Mëni një rast – dosjeve të auditimit nga ndonji raport auditorit

	Literatura: Libri - Auditimi i avancuar
Java e Shtatë	Mostrimi, Metodrat, testet dhe procedurat në auditim / f.187-203/ - Pyetje për diskutim / f.193,Tab.30,f.200-201/ - Raste studimore – punë e pavarur - Merni një rast – mostrimin dhe metodat nga raportet e auditorëve Literatura: Libri - Auditimi i avancuar
Java e Tetë	Diskutime dhe vlerësimi i parë - Rasteve studimore – puna e pavarur - Test kontrolli – verifikim i njohurive
Java e nëntë:	Auditimi i zërave të pasqyrave financiare /f.221-232 / - Pyetje për diskutim /f.232-236/ - Raste studimore – punë e pavarur - Merni një rast – f.230,tab.34/ Literatura: Libri - Auditimi i avancuar
Java e dhjetë:	Auditimi i procesit të furnizimit dhe të shitjes - Pyetje për diskutim /f.232-236/ - Raste studimore – punë e pavarur - Merni një rast – furnizimet dhe shitjet nga kontabiliteti Literatura: Libri - Auditimi i avancuar
Java e njëmbëdhjetë:	Auditimi i llogarive të arkëtueshme ,llogarive të pagueshme dhe stoqeve - Pyetje për diskutim /f.232-236/ - Raste studimore – punë e pavarur - Merni një rast – LL/A,LL/P dhe Stoqet Literatura: Libri - Auditimi i avancuar
Java e dymbëdhjetë:	Auditimi i pasurisë fikse dhe investimeve financiare - Pyetje për diskutim /f.232-236/ - Raste studimore – punë e pavarur - Merni një rast – pasurit fikse dhe investimet kapitale Literatura: Libri - Auditimi i avancuar
Java e trembëdhjetë:	Prezantimi i projekteve Rasteve studimore – puna e pavarur
Java e katërbëdhjetë:	Pergatitje per testin e dyte
Java e pesëmbëdhjetë:	Komunikimi i rezultateve të auditimit - Pyetje për diskutim - Vlerësimi final i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Nga studentet kërkohet që të jenë të rregullt në pjesën e ligjëratave dhe ushtrime.
- Kontributi i studenteve gjatë formës së bashkëbisedimit dhe bashkëparticipimit me studentët, do të vlerësohet.
- Mësimi aktiv kërkon që studentët të reflektojnë mbi gjërat që diskutohen e jo të jenë pranues pasivë të informatave që u jepen.
- Ata janë inkurajuar që të shtrojnë pyetje.
- Po ashtu do të organizohet edhe puna grupore, në mënyrë që studentët të diskutojnë çështjet relevante dhe të këmbëjnë mendimet e tyre.